



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.21

20 mars

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7276 datë 20.2.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	845
Vendim i KM nr. 99, datë 15.2.2012	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2012, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave.....	846
Vendim i KM nr. 100, datë 20.2.2012	Për dhënie ndërtese për selinë qendrore të Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.....	848
Vendim i KM nr. 106, datë 1.2.2012	Për trajtimin e punonjësve, që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos.....	852
Vendim i KM nr. 107, datë 1.2.2012	Për miratimin e rregullave për paraqitjen, hapjen dhe vlerësimin e ofertave për privatizimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos.....	853
Vendim i KM nr. 108, datë 15.2.2012	Për mbylljen e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Buenos Aires (Argjentinë).....	861
Vendim i KM nr. 111, datë 15.2.2012	Për miratimin e kontratës shtesë të koncesionit “Për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Aurora Konstruksion” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit Vlushë, miratuar me vendimin nr. 713, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave”..	862
Vendim i KM nr. 112, datë 15.2.2012	Për heqjen nga fondi kullor kombëtar të sipërfaqes në ngastrën nr. 37, të ekonomisë kullorë “Vllahat-Dhrovian”, Delvinë, që do të përdoret nga shoqëria “Dinamika”, sh.p.k. për karrierë guri	862

Vendim i KM nr. 113, datë 15.2.2012	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2012, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare.....	863
Vendim i KM nr. 114, datë 15.2.2012	Për emërimin e kryetarit të Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës.....	864
Vendim i KM nr. 116, datë 15.2.2012	Për riorganizimin e statistikave bujqësore në Republikën e Shqipërisë.....	865
Vendim i KM nr. 117, datë 15.2.2012	Për procedurat dhe afatet e rimbursimit të pagesës në të holla të parcelave të ndërtimeve informale, për personat që përfitojnë nga e drejta e pagesës me bono privatizimi.....	866
Vendim i KM nr. 125, datë 22.2.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore”	867
Udhëzim i MMPAU nr.2/1, datë 9.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 29.6.2010 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”	869
Udhëzim i MF nr.6, datë 28.2.2012	Për disa shtesa në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar.....	870
Kërkesë e MPPT nr.692/1, datë 22.2.2012	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Lezhë.....	876
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Mirash Ndrec Tosku.....	876

DEKRET
Nr. 7276, datë 20.2.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 14 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------------|------------------------------|
| 1. Saima Smajl Kapijaj (Dibra) | 20. Tefta Fatmir Kelmendi |
| 2. Suada Mustafë Kapijaj | 21. Dritan Shefqet Kelmendi |
| 3. Senada Mustafë Kapijaj | 22. Sazan Shefqet Kelmendi |
| 4. Sead Mustafë Kapijaj | 23. Ali Isa Smaja |
| 5. Sanije Lan Pepaj | 24. Agim Brahim Zenelaj |
| 6. Skënder Rifat Pepaj | 25. Fatjeta Xhemal Zenelaj |
| 7. Jetmir Rifat Pepaj | 26. Armando Agim Zenelaj |
| 8. Lirie Shaban Asllani | 27. Genci Petrit Zyka |
| 9. Anila Nuredin Asllani | 28. Fjoralba Genci Zyka |
| 10. Arbër Nuredin Asllani | 29. Drita Shevqet Hasapapaj |
| 11. Danjeda Vangjel Shehu | 30. Sami Hiqmet Dema |
| 12. Vera Loni Ziu | 31. Aspasia Kostandin Roça |
| 13. Ivo Mijo Mikulij | 32. Andoneta Kostandin Roça |
| 14. Vladimir Ivo Mikulij | 33. Erland Karafil Naska |
| 15. Emine Maliq Deliallisi | 34. Edip Njazi Pilku |
| 16. Ilirjan Bajram Bylykbashi | 35. Anila Edip Pilku |
| 17. Rakela Refat Lamçe | 36. Ena Edip Pilku |
| 18. Panajot Sava Kostandini | 37. Thanas Jorgji Dhima |
| 19. Persefoni Sava Kostandini | 38. Pjetër Zaharia Bushkoviç |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi



VENDIM
Nr. 99, datë 15.2.2012

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2012, PËR BASHKËSITË FETARE, QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shuma 99 243 000 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e dyzet e tri mijë) lekë, e miratuar për financimin e bashkësive fetare, për vitin 2012, të përdoret sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, në përputhje me ndarjen e mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 28 160 000 (njëzet e tetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të ndarë si më poshtë vijon:

i) 11 400 000 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii) 14 760 000 (katërmëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

iii) 2 000 000 (dy milionë) lekë, për rikonstruksionin e kryesisë së KMSH-së.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 24 370 000 (njëzet e katër milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të ndarë si më poshtë vijon:

i) 19 560 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii) 4 440 000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

iii) 370 000 (treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për riparimin e objektit, kisha Bestrovë.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 24 720 000 (njëzet e katër milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekë të ndarë si më poshtë vijon:

i) 3 960 000 (tre milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii) 20 760 000 (njëzet milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 21 993 000 (njëzet e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tri mijë) lekë, të ndarë si më poshtë vijon:

i) 3 000 000 (tre milionë) lekë për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii) 11 993 000 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tri mijë) lekë për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit “Odeoni”;

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

I. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me shumën 28 160 000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 11 400 000 lekë, për 95 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve, në shumën 14 760 000 lekë për 123 arsimtarë.

3. Për rikonstrukcion dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit, në shumën 2 000 000 lekë për objektin Selia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

II. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, me shumën 24 370 000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit, në shumën 19 560 000 lekë për 163 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve, në shumën 4 440 000 lekë për 37 arsimtarë.

3. Mbështetje për riparimin e objektit kisha Bestrovë, në shumën 370 000 lekë.

III. Kisha Katolike, me shumën prej 24 720 000 lekësh, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit, në shumën 3 960 000 lekë për 33 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën 20 760 000 lekë për 173 arsimtarë.

IV. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, me shumën 21 993 000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit, në shumën 3 000 000 lekë për 25 punonjës.

2. Për rikonstrukcion e mirëmbajtje të objekteve të kultit në shumën 11 993 000 lekë për objektin "Odeon".

3. Për Kryegjyshatën Botërore si kryeqendër e bektashinjve, për veprimtari të ndryshme, në shumën 7 000 000 lekë, të ndarë si më poshtë:

i) Zhvillimin e Kongresit Bektashian, shpenzimet për të cilin parashikohen në shumën 2 500 000 lekë.

ii) Simpoziumi ndërkombëtar për bektashizmin, rolin e ish-Kryegjyshit Botëror, Haxhi Dedë Reshat Bardhi, shpenzimet për të cilin parashikohen me shumën 1 500 000 lekë.

iii) Për shpenzime pritjesh e përcjelljesh, si edhe për udhëtim në vende ku ajo ushtron veprimtarinë e saj, si edhe në vendet ku ka gjyshata në vartësi të saj etj., parashikohen 3 000 000 lekë.



VENDIM
Nr. 100, datë 20.2.2012

**PËR DHËNIE NDËRTESE PËR SELINË QENDRORE TË PARTISË PËR DREJTËSI,
INTEGRIM DHE UNITET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 e 22/1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kati i parë i ndërtesës, dhënë në përdorim për selinë qendrore të ish-Partisë Demokratike, Tiranë, i ndodhur në rrugën “Myslym Shyri”, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, të jepet si ndërtesë për selinë qendrore të Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.


2. Vendimi nr. 4, datë 5.1.2002 i Këshillit të Ministrave “Për dhënie ndërtese për selinë qendrore të Partisë Demokratike”, shfuqizohet.


3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Relievi i Tiranës, Shk.1:500, viti 1981 azhornuar në vitin 1993, marrë nga planshetat Q-9 dhe Q-10, zona te kopshti afër shkollës “Alqi Kondi”






Drejtoria ()



d₁ 150 x 150
d₂ 150 x 160
n = 2.50

Solli (1st Impo. rreze)





VENDIM
Nr. 106, datë 1.2.2012

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I
RISTRUKTURIMIT TË SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, PATOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 58 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 6 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos, që dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit, gjatë periudhës nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi deri në çastin e privatizimit të shoqërisë, përveç trajtimeve që parashikohen nga Kodi i Punës, përfitojnë, për një periudhë njëvjeçare, pagesë sipas pagës bruto të vitit të fundit të punës. Në përfundim të kësaj periudhe, punonjësit kanë të drejtë të aplikojnë për të ardhurën nga papunësia.

2. Periudha, gjatë së cilës këta punonjës do të marrin pagesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, njihet periudhë sigurimi, për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, të invaliditetit e atij familjar dhe të barrë lindjes kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror nga “Albpetrol” sh.a., Patos. Periudha e sipërpërmendur e pagesës të shënohet në librezën e punës.

3. Përfitojnë nga ky vendim të gjithë punonjësit aktualë të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos, që kanë qenë të punësuar në këtë shoqëri për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet pa ndërprerje, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Përfshihen nga përfitimi i të drejtave të parashikuara në këtë vendim ata punonjës, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit. Punonjësve u ndërpritet kompensimi që përfitojnë sipas këtij vendimi në rast se vërtetohet që ata zhvillojnë veprimtari ekonomike si më sipër.

5. Të gjitha fondet e nevojshme për kompensimin e këtyre punonjësve dhe detyrimet për sigurimet, shoqërore e shëndetësore, të mbulohen nga të ardhurat e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos, përpara përfundimit të procesit të privatizimit. Pas përfundimit të procesit të privatizimit, këto fonde do të mbulohen nga të ardhurat e privatizimit.

6. Pagesat e punonjësve të bëhen nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse.

7. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 107, datë 1.2.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PARAQITJEN, HAPJEN DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për paraqitjen, hapjen dhe vlerësimin e ofertave për privatizimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos, sipas shtojcave 1, 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1
RREGULLAT PËR PARAQITJEN, HAPJEN DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E “ALBPETROL” SHA

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të neneve 6 dhe 8 të ligjit nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos”, dhe të vendimit nr. 329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, ka hartuar rregullat për paraqitjen dhe hapjen e ofertave në privatizimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos.

I. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtyre rregullave, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

“Kontratë”, kontrata e blerjes së aksioneve që ministria do të nënshkruajë me investitorin, i cili do të blejë aksionet.

“Albpetrol”, shoqëria anonime shqiptare “Albpetrol” sh.a., e cila është subjekt i privatizimit, në përputhje me ligjin nr. 10 490, datë 15.12.2011.

“Kandidati”, investitori strategjik ose bashkimi i përkohshëm i shoqërive/konsorciumi, të cilëve u ofrohen për blerje aksione të shoqërisë.

“Investitor strategjik”, një shoqëri tregtare që e vetme plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2.1, shkronjat “a”, “b”, “c” të kreut II të këtij dokumenti.

“Bashkim i përkohshëm i shoqërive/konsorcium”, marrëveshja e shkruar ndërmjet dy ose më shumë personave juridikë, që ka për objekt blerjen e aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a.,



ku përcaktohen roli, përgjegjësitë dhe përqindjet e zotërimit të aksioneve të kësaj shoqërie nga secili. Në marrëveshje duhet të përcaktohet si shoqëri kryesuese njëra nga shoqëritë pjesëmarrëse, e cila të përfaqësojë bashkimin/konsorciumin në nënshkrimin e kontratës dhe në çdo nismë tjetër.

“Komision”, komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili krijohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

“Ministria”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë.

“Ofertë”, oferta e paraqitur nga kandidatët për blerjen e aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

“Ofertë e përputhur”, një ofertë, që përputhet me të gjithë termat, kushtet, kriteret dhe specifikimet e dokumenteve të tenderit.

“Aksione” do të thotë 13 360 997 (trembëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) aksione nominative të “Albpetrol”-it, me një vlerë nominale prej 1 000 000 (një mijë) lekë secila, plotësisht të shlyera, që i korrespondojnë 100% të të gjithë kapitalit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., të cilat u janë ofruar kandidatëve, në përputhje me ligjin nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos”.

Në këto rregulla, termat “ofertë”, “tender” dhe derivatet e tyre (kandidat/tenderues, ofruar/tenderuar, ofertë/tenderi etj.), janë sinonime dhe “ditë” do të thotë ditë kalendarike, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë vendim. Njëjës, gjithashtu, kuptohet shumës.

II. TË PËRGJITHSHME

1. Organizimi i tenderit

1.1 Forma e përzgjedhjes së kandidatëve të interesuar për blerjen e aksioneve të “Albpetrol”-it është tender i hapur me një fazë, sipas procedurës së parashikuar në këtë vendim. Ministria organizon tenderin dhe pranon oferta për blerjen e aksioneve dhe i vlerëson ato.

2. Kriteret e kualifikimit

2.1 Kandidati duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) Të jetë person juridik, që zotëron garanci financiare dhe të jetë i mirënjohur në veprimtarinë e tij ekonomike. Personi juridik duhet të plotësojë standardet e certifikimit ISO 9000 ose standardet e njësuara me to;

b) Të jetë shoqëri e specializuar në fushat e kërkimit, zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të naftës dhe të gazit, e cila t’i ketë ushtruar këto veprimtari në nivel ndërkombëtar për jo më pak se 5 (pesë) vjet;

c) Të ketë një kapital tërësisht të paguar në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro apo barasvlerën e kësaj shume në valutë, në të cilën është shprehur kapitali, asetet neto e, sipas rastit, asetet neto të konsoliduara duhet të jenë të paktën 100 000 000 (njëqind milionë) euro;

d) Nëse ofertat paraqiten nga në bashkim i përkohshëm i shoqërive/konsorcium, duhet të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

i) Investitori strategjik duhet të zotërojë të paktën 30% të kapitalit dhe të drejtën e votës në shoqërinë e përbashkët/konsorcium;

ii) Oferta duhet të përfshijë të gjithë informacionin e listuar në pikat e mësipërme 2.1 dhe 2.2;

iii) Të gjithë pjesëmarrësit e bashkimit të përkohshëm të shoqërive/konsorciumit do të jenë përgjegjës solidarë dhe individualisht për zbatimin e marrëveshjes, konsorciumit dhe të kontratës së privatizimit;

iv) Një kopje e marrëveshjes, e lidhur nga përfaqësuesit e bashkimit të përkohshëm të shoqërive/konsorciumit duhet të paraqitet me ofertën. Çdo modifikim i kësaj marrëveshjeje, përfshirë dhe rastet e ndryshimit të përqindjes së interesave të zotëruara nga investitori strategjik dhe

nga secili pjesëmarrës në shoqërinë e përbashkët/konsorcium, pas paraqitjes së ofertës, mund të lejohet vetëm me miratimin paraprak të ministrisë.

Mosplotësimi i këtyre kriterëve, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 2, më sipër, përbën kusht për skualifikimin e kandidatit.

2.2 Kandidatët duhet që, si pjesë e ofertës, të paraqesin dokumentet ligjore që vërtetojnë se personi, që ka nënshkruar ofertën, ka të drejtë ta bëjë këtë në emër dhe për llogari të kandidatit. Mungesa e paraqitjes së këtyre dokumenteve ligjore sjell si pasojë refuzimin e ofertës.

2.3 Secili kandidat do të paraqesë vetëm një ofertë. Një kandidat, i cili paraqet ose merr pjesë në më shumë se një ofertë, do të skualifikohet nga të gjitha ofertat e paraqitura.

2.4 Kandidati do të përballojë të gjitha shpenzimet e lidhura me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij dhe ministria, në asnjë rast, nuk do të jetë përgjegjëse apo e detyruar për këto shpenzime, pavarësisht nga ecuria ose rezultati i procesit të tenderit.

III. DOKUMENTET E TENDERIT

1. Në ofertë do të përfshihen angazhimet e mëposhtme:

- a) Pranimi nga kandidati i termave dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- b) Pranimi nga kandidati i detyrimeve që rrjedhin nga vlerësimi i tenderit.

2. Në dokumentet e tenderit do të përfshihen dokumentet e mëposhtme:

a) Emri i kandidatit;

b) Kopje të vendimit për regjistrimin në regjistrin tregtar të shoqërive ose një dokument i barasvlerëshëm, i dhënë nga autoritetet kompetente të vendit përkatës të kandidatit;

c) Dokumente që provojnë secilin nga kriteret e kualifikimit, të parashikuara në pikën 2.1 më sipër, përfshirë pasqyrat financiare të audituara për vitet 2009 dhe 2010 dhe dokumenti që provon se kandidati nuk është në likuidim, ka aftësi paguese dhe nuk është i kërcënuar nga ndonjë pretendim i kreditorëve. Në rast se kandidati është një bashkim i përkohshëm i shoqërive/konsorcium, dokumente të tilla duhet të jepen nga secili prej pjesëmarrësve;

d) Sasia në euro e çmimit total, që kandidati ofron për blerjen e aksioneve;

e) Një deklaratë që provon mundësinë financiare të kandidatit, për të përmbushur në kohë detyrimet që rrjedhin nga “Plani i biznesit” (siç përcaktohet në pikën 3 më poshtë), sipas afateve të parashikuara në të. Në qoftë se kërkohet financim për këtë qëllim, kandidati duhet të paraqesë një deklaratë bankare, që vërteton se mjetet financiare të kandidatit janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga plani i biznesit.

3. Planbiznesi i propozuar për “Albpetrol”, për vitet 2012-2017.

3.1 Ofertuesi do të prezantojë si pjesë kryesore të dokumentacionit të tenderit një plan biznesi, për vitet 2012-2017. Plani i biznesit do të përmbajë në detaje planet e ofertuesit dhe kapacitetet e tij:

a) për të financuar “Albpetrol”-in, me qëllim përbalimin e nevojave operationale të tashme dhe të ardhme, si dhe nevojat e marketingut;

b) për të modernizuar dhe ristrukturuar asetet teknologjike të “Albpetrol”-it;

c) për të zgjeruar linjat e prodhimit të “Albpetrol”-it dhe për të racionalizuar prodhimet në qarkullim;

d) për të zgjeruar në mënyrë substanciale vendin e “Albpetrol”-it në tregun shqiptar, rajonal dhe atë botëror, dhe për të zhvilluar një plan marketingu largpamës dhe të fuqishëm;

e) për të rritur efikasitetin ekonomik të “Albpetrol”-it, fitimet e tij dhe vlerën e aksioneve në treg;

f) për të treguar kujdes maksimal për fuqinë punëtore të “Albpetrol”-it, ndërsa racionalizon nevojat aktuale dhe të ardhme të fuqisë punëtore;

g) për të forcuar markat tregtare (*brande-et*) të produkteve të “Albpetrol”-it;



h) për të zbatuar një plan zhvillimi dhe prodhimi afatgjatë të naftës dhe gazit, i cili të ketë si qëllim të bëjë të mundur arritjen e synimeve të radhitura më sipër.

4. Garancia e ofertës

4.1 Kandidati do të paraqesë, si pjesë të ofertës së tij, një garanci prej 10% të çmimit total, që kandidati ofron për blerjen e aksioneve.

4.2 Garancia duhet të jetë në formën e një garancie bankare, e lëshuar nga një bankë, që bën pjesë në 50 bankat kryesore të botës, e zgjedhur nga kandidati. Format i garancisë bankare duhet të jetë në përputhje me formën e garancisë së ofertës, sipas shtojcës 2. Garancia e ofertës duhet të jetë e vlefshme, të paktën për një periudhë prej 28 ditësh pune, pas periudhës së vlefshmërisë së ofertës së paraqitur, pa përfshirë ndonjë periudhë të shtyrjes së mëvonshme, të kërkuar sipas pikës 3.2 të kreut IV.

4.3 Ministria do të refuzojë çdo ofertë të pashoqëruar nga një garanci, sipas pikave 4.1 dhe 4.2 më sipër, si të pavlefshme. Garancia e ofertës për një bashkim të përkohshëm shoqërisë/konsorcium duhet të jetë në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit të përkohshëm të shoqërisë/konsorciumit.

4.4 Garancia e ofertës së kandidatëve jofitues do t'u kthehet këtyre të fundit, jo më vonë se 28 ditë pune, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kësaj garancie.

4.5 Garancia e ofertës për kandidatin fitues do të kthehet, kur kandidati ka dhënë garancinë e kontratës, së kërkuar nga marrëveshja, brenda datës së specifikuar në të.

4.6 Garancia e ofertës do të tërhiqet nga Ministria:

a) në qoftë se kandidati nuk pranon korrigjimin e çmimit të tij të ofertës, në përputhje me pikën 5.2, të kreut VI;

b) në rast se kandidati tërhiqet nga oferta e propozuar prej tij, pas hapjes së saj;

c) në rastin e një kandidati fitues, në qoftë se ai nuk arrin, që brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentet standarde të tenderit;

- të nënshkruajë marrëveshjen;

- të dorëzojë garancinë e kontratës, të kërkuar nga marrëveshja.

d) Në rast se kandidati paraqet dokumente ose informacione të rreme.

IV. PËRGATITJA E OFERTAVE

1. Gjuha e përdorur për ofertën dhe për të gjithë korrespondencën dhe dokumentet, që lidhen me tenderin, të shkëmbyera ndërmjet kandidatit dhe ministrisë, duhet të jetë shqip dhe anglisht. Dokumentet ndihmëse dhe literatura e shkruar, e dhënë nga kandidati, mund të jenë në gjuhë tjetër, të shoqëruara nga një përkthim i saktë në shqip ose në anglisht. Në këto raste, për qëllimet e interpretimit të ofertës, gjuha anglisht do të jetë mbizotëruese.

2. Çmimi i ofruar nga kandidati do të jetë i shprehur tërësisht në euro.

3. Vlefshmëria e ofertës

3.1 Oferta do të jetë e vlefshme për një periudhë prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh, pas datës së hapjes së ofertës.

3.2 Në rrethana të veçanta, para mbarimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës origjinale, ministria mund të kërkojë që kandidatët të zgjatin afatin e vlefshmërisë për një periudhë shtesë. Kërkesa dhe përgjigja ndaj saj duhet të bëhen me letër rekomande ose me faks. Një kandidat mund të refuzojë kërkesën, pa humbur garancinë e tij të ofertës. Një kandidat, që pranon kërkesën, nuk do t'i kërkohet ose lejohet të modifikojë ofertën e tij, por do t'i kërkohet të shtyjë vlefshmërinë e garancisë së tij të ofertës, për periudhën e zgjatjes dhe në përputhje me pikën 4 të kreut III.

4. Format i dhe nënshkrimi i ofertës

4.1 Kandidati do të përgatisë një origjinal të dokumenteve të tenderit, të treguara në pikat 1 dhe 2 të kreut III, lidhur me dokumentet e përshkruara në pikat 2.1 dhe 2.2 të kreut II, të cilat duhet

të kenë shënuar qartë fjalën “ORIGJINAL” mbi zarf. Përveç kësaj, kandidati do të paraqesë 3 (tri) kopje të ofertës, të cilat duhet të kenë të shënuara qartë fjalën “KOPJE” mbi zarf. Në rastet e mospërputhjes midis tyre, do të jetë i vlefshëm origjinali.

4.2 Origjinali dhe të gjitha kopjet e ofertës duhet të jenë të shtypura ose të shkruara me bojë të pashlyeshme (në rastin e kopjeve, fotokopjet janë gjithashtu të pranueshme) dhe duhet të jenë të nënshkruara nga një person ose persona rregullisht të autorizuar, për të nënshkruar në emrin e kandidatit. Personi apo personat që nënshkruajnë ofertën do të nënshkruajnë të gjitha faqet e ofertës, si dhe do të nënshkruajnë vendet ku janë bërë shënime apo ndryshime.

4.3 Asnjë pjesë e ofertës, modifikim, heqje apo shtesa nuk do të konsiderohen gjatë vlerësimit të ofertës, nëse të tilla pjesë të ofertës, modifikime, heqje apo shtesa nuk janë nënshkruar nga personi ose personat, që kanë nënshkruar ofertën fillestare.

V. PARAQITJA E OFERTËS

1. Vulosja dhe vlerësimi i ofertave

1.1 Kandidati do të vulosë origjinalin dhe secilën kopje të ofertës në zarfe të veçanta. Në secilën prej kopjeve duhet të jetë e shënuar sipas rregullit: “ORIGJINAL” ose “KOPJE”. Zarfet që përmbajnë kopje duhet të vulosen në një zarf të jashtëm të shënuar “KOPJE”.

1.2 Zarfi i shënuar “ORIGJINAL” duhet:

a) t’i adresohet ministrisë në adresën e mëposhtme:

Republika e Shqipërisë
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1001
Tiranë, Shqipëri

b) të mbajë referencën “Privatizimi Albpetrol-ofertë për blerjen e aksioneve të “Albpetrol”-it”;

c) të japë një paralajmërim për moshapjen para kohe dhe para datës së dhënë në pikën 1 të kreut VI.

1.3 Zarfet me shënimin “KOPJE” dhe zarfi i jashtëm duhet:

a) të adresohen në ministri me adresën e mëposhtme:

Republika e Shqipërisë
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1001
Tiranë, Shqipëri

b) të mbajnë referencën “Privatizimi Albpetrol-ofertë për blerjen e aksioneve të “Albpetrol”-it”;

c) të japin një paralajmërim për moshapjen para kohe dhe para datës së dhënë në pikën 1 të kreut VI.

1.4 Veç identifikimit të kërkuar në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut V, të gjitha zarfet duhet të tregojnë emrin dhe adresën e kandidatit, për të mundësuar që të kthehet e pahapur oferta, në rast se ajo deklarohet e “VONUAR”, sipas pikës 3 të kreut V.

1.5 Në qoftë se zarfet nuk janë vulosur dhe shënuar si më sipër, ministria nuk mban përgjegjësi për dërgimin në një vend të gabuar dhe hapjen para kohe të ofertës.

2. Afati për paraqitjen e ofertave

2.1 Ministria duhet të marrë ofertat e shënuara “ORIGJINAL” dhe “KOPJE” në adresat e specifikuar në pikat 1.2 ose 1.3 të kreut V, jo më vonë se 4 (katër) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



2.2 Ministria, në situata të veçanta dhe me zgjedhjen e saj, mund të zgjasë afatin për paraqitjen e ofertave. Në një rast të tillë, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ministrisë dhe kandidatëve që më parë i nënshtroheshin afatit fillestar, pas kësaj do t'i nënshtrohen afatit të shtyrë, duke njoftuar më parë të gjithë kandidatët.

3. Ofertat e vonuara

Ndonjë ofertë e marrë nga ministria pas afatit për paraqitjen e ofertave, parashikuar në pikën 2 të kreut V, do t'i kthehet e pahapur kandidatit.

VI. HAPJA E OFERTËS DHE VLERËSIMI

1. Hapja e ofertës

1.1 Komisioni, në prani të kandidatëve, do të hapë zarfet e shënuara "ORIGINAL", në ministri, në kohën e duhur për paraqitjen e ofertës, siç specifikohet në pikën 2.1 të kreut V. Hapja e ofertës është publike.

1.2 Emrat e kandidatëve, çmimi i ofertës dhe prania (apo mungesa) e garancisë së ofertës do të njoftohen nga komisioni në hapje.

1.3 Komisioni do të përgatisë procesverbalet e hapjes së ofertës. Një noter publik duhet të jetë i pranishëm dhe të konfirmojë procesverbalet e hapjes së ofertës.

2. Konfidencialiteti i procesit të vlerësimit

Informacioni për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe rekomandimet për shpalljen fitues nuk do të zbulohen për kandidatët ose ndonjë person tjetër, që nuk janë të lidhur zyrtarisht me një proces të tillë, deri sa të jetë shpallur vlerësimi për kandidatin fitues. Ndonjë përpjekje nga një kandidat për të influencuar në përpunimin e ofertave ose vendimet e vlerësimit të komisionit mund të rezultojë në refuzim të ofertës së kandidatit.

3. Sqarimi i ofertave dhe komunikimi me komisionin e vlerësimit të ofertave

3.1 Komisioni, në rast paqartësie, mund t'i kërkojë kandidatëve ndonjë sqarim rreth dokumenteve tashmë të dhëna. Në këtë rast, kandidatët duhet të jenë të gatshëm për të dhënë sqarimet, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës së komisionit. Mosdhënia e sqarimeve të kërkuara brenda afatit të sipërpërmendur shkakton përjashtimin nga tenderi.

3.2 Çdo komunikim, ndërmjet kandidatëve dhe komisionit, do të bëhet vetëm në mënyrë të shkruar dhe vetëm nëpërmjet faksit apo letrës rekomande.

4. Shqyrtimi i ofertave dhe përputhshmëria

4.1 Para vlerësimit të detajuar të ofertave, komisioni do të përcaktojë nëse çdo ofertë:

- a) plotëson kriteret e kualifikimit, të përcaktuara në pikën 2 të kreut II;
- b) shoqërohet me garancinë e ofertës, së kërkuar në përputhje me pikën 4 të kreut III;
- c) është në thelb, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

4.2 Një ofertë e përputhur në përmbajtje është një ofertë që përputhet me të gjithë termat, kushtet dhe specifikimet e dokumenteve të tenderit, pa devijime apo rezervime materiale. Devijim apo rezervim material konsiderohet:

a) një kufizim në ndonjë mënyrë thelbësore, të papajtueshme me dokumentet e tenderit, i të drejtave të ministrisë ose detyrimeve të kandidatëve sipas marrëveshjes;

b) korigjimi, i cili mund të ndikojë padrejtësisht pozicionin konkurrues të kandidatëve të tjerë, që prezantojnë oferta të përputhura.

4.3 Në qoftë se një ofertë nuk është e përputhur, ajo nuk do të vlerësohet nga komisioni.

5. Ndreqja e gabimeve

5.1 Komisioni do të kontrollojë të gjitha ofertat për të qenë përgjegjës për ndonjë gabim aritmetik. Ku ka një mospajtim midis shumave në shifra dhe në fjalë, shumat në fjalë do të jenë mbizotëruese.

5.2 Shuma e deklaruar në ofertë do të rregullohet nga komisioni, në përputhje me pikën 5,1 dhe, me marrëveshjen e kandidatit, do të konsiderohen si detyruese për kandidatin. Në qoftë se kandidati nuk pranon shumën e korrigjuar të ofertës, oferta e tij nuk do të pranohet dhe garancia e tenderit mund të humbasë në përputhje me pikën 4.6 shkronja “a” të kreut III.

6. Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave

6.1 Komisioni do të vlerësojë dhe do të krahasojë vetëm ofertat e përcaktuara, të cilat janë të përputhura sipas pikës 4 të kreut VI.

6.2 Në zbatim të vendimit nr. 329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave, vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

6.3 Pas vlerësimit të ofertave, komisioni përgatiti vendimin, në të cilin përfshihen renditja e kandidatëve dhe kandidatët e skualifikuar. Vendimi i komunikohet individualisht çdo kandidati në adresën e deklaruar në ofertë.

7. Mossuksesi i procedurës

7.1 Procedura do të konsiderohet e pasuksesshme, në rast se asnjë ofertë nuk paraqitet apo asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me procedurën e tenderit.

VII. ANKIMIMI

1. Kundër vendimit të komisionit, kandidatët mund të paraqesin ankim, brenda 5 (pesë ditëve) nga data e marrjes së njoftimit, pranë Ministrinë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ministri kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së ankimit.

VIII. MIRATIMI I VLERËSIMIT DHE NËNSHKRIMI I KONTRATËS

1. Komisioni do t'i paraqesë Këshillit të Ministrave raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave të klasifikuara, në përputhje me kriteret e përmendura në pikën 6.2 të kreut VI. Këshilli i Ministrave miraton raportin e vlerësimit të ofertave dhe shpall kandidatin fitues.

2. Këshilli i Ministrave mund që, në çdo kohë përpara shpalljes së fituesit të anulojë procedurën e tenderit pa u dhënë argumente kandidatëve.

2. Njoftimi për vlerësimin

2.1 Përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertës, ministria do të njoftojë kandidatin fitues dhe do të fillojë negociimin e kontratës me të.

3. Nënshkrimi i kontratës

3.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas shpalljes së fituesit kandidati fitues duhet të nënshkruajë kontratën me ministrinë dhe të dorëzojë garancinë e kontratës. Në të kundërt, negociimet do të fillojnë me kandidatin e klasifikuar i dyti dhe, pastaj me kandidatët e tjerë, të klasifikuar pas tij, në përputhje me të njëjtën procedurë.

3.2 Afati i treguar në pikën 3.1 të kreut VIII, mund të shtyhet sipas marrëveshjes ndërmjet palëve për 30 (tridhjetë) ditë, por jo më shumë se një herë.

3.3 Garancia e kontratës do të jetë 20% e çmimit të blerjes dhe do të jetë sipas formatit në shtojcën 2, bashkëlidhur këtyre rregullave.

3.4 Garancia e kontratës do t'i kthehet blerësit, pas pagimit të plotë të çmimit të kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në të (në kontratë).

4. Miratimi i kontratës

Kontrata, pasi nënshkruhet nga ministri përgjegjës dhe blerësi, miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.



SHTOJCA 2

Koka e letrës së bankës
Datë _____
Republika e Shqipërisë
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1001
Tiranë
Shqipëri

LETËR GARANCIE

Ne jemi të informuar se klienti ynë _____ (më poshtë “Kandidati”) do t’ju paraqesë ofertën e tij për blerjen e aksioneve të zotëruara nga shteti, të kompanisë shqiptare “Albpetrol” sh.a., ofertë e marrë tashmë prej jush, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për paraqitjen dhe hapjen e ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime “Albpetrol” sh.a.” (më poshtë “instruksionet”).

Në përputhje me pikën 4.4 të rregullave, kandidati i kërkohet të paraqesë një garanci të tenderit në sasinë prej _____ eurosh.

Duke qenë rregullisht të regjistruar, me seli në _____, me kërkesë të kandidatit, angazhohemi për t’ju paguar menjëherë, në mënyrë të pakthyeshme, sipas kërkesës suaj të parë me shkrim, një sasi deri në _____ euro, pa ndonjë njoftim ose kufizim a kushtëzim dhe pavarësisht nga ndonjë kundërshtim i ngritur nga kandidati.

Detyrimet tuaja sipas kësaj letrë të garancisë do të përfundojnë në datën e treguar në pikën 4.4.2 të rregullave ose, në rast se është përcaktuar kandidati, në datën e treguar në pikën 4.4.5 të po këtyre rregullave. Kërkesa juaj e shkruar duhet të na ketë arritur deri në atë datë, përndryshe ndonjëherë dhe të gjitha kërkesave përkundrejt nesh, sipas kësaj letrë garancie, do t’u mbarojë afati automatikisht.

Originali i këtij dokumenti duhet të kthehet brenda afateve të specifikuara në pikën 4.4.4 ose në pikën 4.4.5 të rregullave ose në ndonjë rast pasi të gjitha kërkesat tuaja të jenë përmbushur.

SHTOJCA 3

Kategoria	Përshkrimi			
1	Teknike	25		
1.1	Kredencialet teknike të blerësit të mundshëm		30	
1.1.1	Qëllimet strategjike të blerësit për “Albpetrol”-in			50
1.1.2	Eksperienca e blerësit në aktivitetet e kërkimit, zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit			25
1.1.3	Aftësitë teknike të blerësit për të mbështetur “Albpetrol”-in			25
2	Planbiznesi 2012-2017		70	
2.1	Kapacitetet			
2.1.1	Plani për riaktivizimin e puseve ekzistuese të “Alpetrol”-it me teknologji të cilat rezultojnë në rritjen e prodhimit, rezervave dhe krijimin e vlerës së përgjithshme			10
2.1.2	Planet për rehabilitimin e njërive të prodhimit për të rritur kapacitetin prodhues në përputhje me rritjen e disponueshmërisë të lëndës së parë dhe kërkesave të tregut			5
2.1.3	Rehabilitimi dhe plani i zgjerimit të tubacionit të transportimit të naftës dhe të gazit duke rritur efikasitetin e këtij shërbimi shtesë të “Albpetrol”-it dhe në përgjithësi plan-rehabilitimi dhe zgjerimi për çdo njësi tjetër shërbimi			10

2.1.4	Plan-shpimi dhe zhvillimi që të përmbajë numrin e puseve, programimin e afatit kohor të shpimeve, metodologjinë dhe kostot e pritshme të shpimit, i hartuar edhe me qëllimin e identifikimit të zonave potencialisht të paeksploruara dhe pak të zhvilluara			5
2.1.5	Plan për rigjenerimin e rezervave			10
2.2	Mjedisi			
2.2.1	Planet për përmirësimin e performancës mjedisore (ajër, ujë, lëndë të ngurta) në përputhje me kërkesat ligjore në Shqipëri (apo edhe kërkesa ligjore më të rrepta) në të gjitha pikat e aktivitetit			20
2.3	Efiçenca			
2.3.1	Plane për automatizimin e procesit për rritjen e efiçencës së prodhimit dhe cilësisë së produktit			5
2.4	Shëndeti dhe siguria			
2.4.1	Përmirësime që duhen zbatuar në lidhje me shëndetin dhe sigurinë			10
2.4.2	Përmirësime që duhen zbatuar në administrim			5
2.5	Kapitali			
2.5.1	Program i plotë i investimeve kapitale gjatë 5 viteve të ardhshme, bazuar në të mësipërmet			10
2.6	Burimet njerëzore			
2.6.1	Planet për zvogëlimin e impakteve sociale si rezultat i racionalizimit të fuqisë punëtore			5
2.6.2	Planet e trajnimit për të përmirësuar aftësitë dhe kompetencat e fuqisë punëtore			5
3	Aspekti financiar	75		
3.1	Oferta		100	

VENDIM

Nr. 108, datë 15.2.2012

PËR MBYLLJEN E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BUENOS AIRES (ARGJENTINË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Buenos Aires (Argjentinë).
2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM

Nr. 111, datë 15.2.2012

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SHITESË TË KONCESIONIT “PËR NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “AURORA KONSTRUKSION” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT VLUSHË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 713, DATË 21.5.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës shtesë të koncesionit “Për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Aurora Konstruksion” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit Vlushë, të miratuar me vendimin nr. 713, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 112, datë 15.2.2012

PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES NË NGASTRËN NR. 37, TË EKONOMISË KULLOSORE “VLLAHAT-DHROVIAN”, DELVINË, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “DINAMIKA”, SHPK PËR KARIERË GURI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga Fondi Kullor Kombëtar dhe çregjistrimin nga zëri kadastral “Kullotë”, të sipërfaqes prej 10 (dhjetë) ha, sipas të dhënave të përcaktuara në lejen minerare nr. 1369, datë 22.6.2009, lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila ndodhet në ngastrën nr. 37 të ekonominë kullosore “Vllahat-Dhrovian”, Delvinë, dhe që do të përdoret nga subjekti “Dinamika”, sh.p.k., për karrierë guri.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të Fondit Kullor Kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, kullotë” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë për veprimtari minerare”, në zbatim të vendimit nr. 1374, datë 10.10.2008 të Këshillit Ministrave “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

3. Vlera e sipërfaqes kullorore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga subjekti “Dinamika”, sh.p.k., në bazë të lidhjes nr. 4 të vendimit nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, subjekti “Dinamika”, sh.p.k., brenda 2 (dy) viteve, me fondet e veta, të përmirësojë 10 (dhjetë) ha kullota, në ngastrat e përcaktuara nga komuna Mesopotam dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Delvinë. Mënyra e përmirësimit deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së përmirësuar të bëhet sipas marrëveshjes, që do të lidhet ndërmjet palëve me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Mesopotam për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr. 1

**SIPËRFAQJA QË HIQET NGA FONDI KULLOR PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË
MINERARE
(Hapje kariere guri gëlqeror)**

Nr.	Ekonomia pyjore/kullorore	Ngastra	Sip. ha	Përdorimi i territorit	Forma e qeverisjes	Funksioni kryesor	Tipi i kullotës	Pronësia
A.	Karierë							
2	E.k. Vllahat-Dhrovian	37	10	Kullotë	Kullotë	Prodhues	Verore	Komuna Mesopotam
	TOTALI		10					

VENDIM

Nr. 113, datë 15.2.2012

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2012, PËR AUTORITETIN
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2012, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, në shumën 266 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë) lekë, të ndarë sipas zërave, të paraqitura në lidhjen nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE PËR VITIN 2012
TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2011	Parashikimi për vitin 2012
A	Të ardhura	330,000,000	266,000,000
B	Shpenzime gjithsej	330,000,000	266,000,000
I	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	79,000,000	75,000,000
II	Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	10,000,000	10,000,000
III	Shpenzimet për materiale	5,500,000	5,500,000
IV	Shpenzimet për shërbime	38,000,000	35,000,000
V	Investimet	197,500,000	140,500,000

VENDIM

Nr. 114, datë 15.2.2012

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË QENDRËS KOMBËTARE TË ARTIT DHE
KULTURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e z. Frok Çupi në detyrën e kryetarit të Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës.
2. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 116, datë 15.2.2012

PËR RIORGANIZIMIN E STATISTIKAVE BUJQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Instituti i Statistikave (në vijim INSTAT) do të jetë institucioni i vetëm përgjegjës në vend për grumbullimin, prodhimin, analizën dhe përhapjen e statistikave të bujqësisë dhe shkëmbimeve tregtare për produktet bujqësore dhe blegtorale.

2. Transferimi i kompetencave për statistikave bujqësore, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit tek INSTAT-i, do të bëhet në dy faza, si më poshtë vijon:

a) Faza e parë do të jetë ngritja e strukturës së statistikave të bujqësisë pranë qendrës së INSTAT-it, e përbërë nga 27 (njëzet e shtatë) punonjës. Kjo fazë mbyllet tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

b) Në përfundim të fazës së parë, struktura aktuale e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (sektorët e statistikave) pakësohet me 27 (njëzet e shtatë) punonjës dhe fondi i pagave për këta punonjës i transferohet INSTAT-it.

c) Faza e dytë do të jetë ngritja e strukturave të statistikave bujqësore në varësi të INSTAT-it, në çdo qark të vendit. Kjo fazë mbyllet brenda datës 31 dhjetor 2012.

ç) Në përfundim të fazës së dytë, struktura aktuale e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (sektorët e statistikave) pakësohet me 20 (njëzet) punonjës. Fondi i pagave për këta punonjës i transferohet qendrës së INSTAT-it.

3. Gjatë vitit 2012, përgjegjësitë e institucioneve për statistikave bujqësore do të jenë, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit do të organizojë vrojtimet 6 - mujore dhe vjetore për treguesit e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

b) Të dhënat e vrojtimeve do t'i dërgohen INSTAT-it, i cili do të bëjë përpunimin, analizën dhe publikimin e treguesve për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, për vitin 2012.

c) INSTAT-i me stafin e tij në qendër merr pjesë dhe vrojton procesin e intervistave në terren nga specialistët e MBUMK-së.

4. Brenda datës 31 dhjetor 2012, të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për statistikave bujqësore në vend i transferohen INSTAT-it.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 117, datë 15.2.2012

PËR PROCEDURAT DHE AFATET E RIMBURSIMIT TË PAGESËS NË TË HOLLA TË PARCELAVE TË NDËRTIMEVE INFORMALE, PËR PERSONAT QË PËRFITOJNË NGA E DREJTA E PAGESËS ME BONO PRIVATIZIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 10 219, datë 4.2.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat, që kanë kryer pagesën e parcelës së objektit informal përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10 219, datë 4.2.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”, dhe që kanë paraqitur kërkesë me shkrim pranë drejtorive të ALUIZNI-t, në qarqe, brenda afatit të parashikuar, kanë të drejtën e rimbursimit të shumave të paguara në të holla, në këmbim të pagesës nëpërmjet bonove të privatizimit.

2. Masa e pagesës së rimbursueshme, për efekt të shlyerjes me bono privatizimi, do të jetë në përputhje me përqindjet e përcaktuara në nenet 19 e 20 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

3. Procedurat përkatëse të hollësishme për rimbursimin e personave që përfitojnë nga e drejta e pagesës me bono privatizimi, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Financave.

4. Drejtoritë e ALUIZNI-t, në qarqe, njoftojnë me shkrim përfituesit për hapjen e llogarive bankare dhe vlerën monetare, për të cilën përfitojnë rimbursim.

5. Personat, që përfitojnë, janë të detyruar të bëjnë pagesën me bono privatizimi të vlerës së rimbursueshme dhe të dorëzojnë pranë drejtorive të ALUIZNI-t, në qarqe, dokumentacionin financiar, që vërteton kryerjen e kësaj pagese, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

6. Moskryerja e pagesës me bono privatizimi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, sjell humbjen e të drejtës së rimbursimit të shumës respektive në para.

7. Me paraqitjen e dokumentacionit financiar të parashikuar në pikën 4 të këtij vendimi, personave u lind e drejta për rimbursim.

8. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të dokumentacionit financiar, që vërteton kryerjen e pagesës me bono privatizimi, pranë drejtorive të ALUIZNI-t, në qarqe, bëhet i mundur transferimi i shumave të rimbursueshme në numrat e llogarive.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 125, datë 22.2.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 521 veta, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Shtesa prej 106 punonjësish është e detajuar sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2012, të njëjtit të qeverisjes qendrore.

3. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore, të përmendura në lidhjen nr. 2, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 2

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Periudhë kohore
03	Këshilli i Ministrave	3			
	Aparati	1	Punonjës gjelbërimi/pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	Aparati	2	Arkivist	6 orë/ditë	vjetore
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	2			
	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
	Aparati	1	Roje	6 orë/ditë	vjetore
06	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	1			
	Instituti i Transportit	1	Pastrues	3 orë/ditë	vjetore
10	Ministria e Financave	10			
	Dega e Thesarit Tiranë	1	Roje	6 orë/ditë	vjetore
	Dogana Qafë Thanë Pogradec	2	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Elbasan	1	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Kakavijë	1	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tre Urat	1	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Shkodër	1	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore



	Dogana Tiranë	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Vlorë	1	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	vjetore
11	Ministria e Arsimit	42			
	DAR në rrethe	13	Pastrues	4 orë/ditë	9 muaj
	ZAR në rrethe	25	Pastrues	3 orë/ditë	9 muaj
	Agjencia Kombëtare e Provimeve	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
	Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
	Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë	1	Pastrues	3 orë/ditë	vjetore
	Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parauniversitar	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	15			
	ZAKP Butrint	5	Ciceron (vëzhgues)	8 orë/ditë	maj-tetor
	ZAKP Butrint	2	Punëtor mirëmbajtje	8 orë/ditë	maj-tetor
	ZAKP Butrint	1	Biletashitës	8 orë/ditë	maj-tetor
	Kalaja Gjirokastër	1	Punëtor mirëmbajtje	8 orë/ditë	qershor-shtator
	Parku Apoloni	1	Vëzhgues	8 orë/ditë	qershor-shtator
	Kalaja Berat	1	Ciceron (vëzhgues)	8 orë/ditë	qershor-shtator
	Qendra e Realizimit të Veprave të Artit	2	Restaurator	5 orë/ditë	mars-dhjetor
	Qendra Kulturore për Fëmijë	1	Piktur	6 orë/ditë	mars-dhjetor
	Qendra Kulturore për Fëmijë	1	Punëtor mirëmbajtje	8 orë/ditë	maj-tetor
15	Ministria e Punëve të Jashtme	7			
	Spektori i Legalizimeve	2	Preparatorë	6 orë/ditë	vjetore
	Spektori i Arkivit	3	Arkivistë	6 orë/ditë	vjetore
	Spektori i Shërbimeve	1	Shpërndarës poste	6 orë/ditë	vjetore
	Spektori i Shërbimeve	1	Lulishtar	6 orë/ditë	vjetore
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	25			
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Mjek	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	1	Mjek	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër	1	Mjek	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër	1	Pastrues	4 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Fier	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Foshnjes Tiranë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Foshnjes Durrës	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Foshnjes Shkodër	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Foshnjes Korçë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e Foshnjes Vlorë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Sanitare	4 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Durrës	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Korçë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Shkodër	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Berat	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Qendra e Zhvillimit Vlorë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e fëmijëve parashkollorë Shkodër	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e fëmijëve shkollorë Tiranë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e fëmijëve shkollorë Shkodër	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Shtëpia e fëmijëve shkollorë Sarandë	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
	Qendra Polivalente Poliçan	1	Mjeke	3 orë/ditë	vjetore
29	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1			
	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1	Punonjës pastrimi	4 orë/ditë	vjetore
	Total numri i punonjësve	106			

UDHËZIM
Nr.2/1, datë 9.2.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 29.6.2010 “PËR DOKUMENTACIONIN E DOMOSDOSHËM PËR TË KËRKUAR LEJE MJEDISORE”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, të pikës 3 të nenit 5 si dhe pikës 1 të nenit 53 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”,

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 2.5 të udhëzimit nr. 2, datë 29.6.2010 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”, shtohet pika 2.6 me këtë përmbajtje:

“2.6 Për kategorinë e lejeve mjedisore të lëshuara në zbatim të nenit 40 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, të shfuqizuar me nenin 11 të ligjit nr. 9890, datë 20.3.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit””, të ndryshuar, personat fizikë dhe juridikë, për t’u ripajisur me leje mjedisore për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis, do të aplikojnë pranë QKL-së duke paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”, si më poshtë vijon:

2.6.1 Kërkesa e personit fizik ose juridik për t’u pajisur me leje mjedisore e shoqëruar me kopje të noteruar të lejes mjedisore të mëparshme.

2.6.2 Përshkrimi i projektit ose veprimtarisë që trajton:

a) Karakteristikat e projektit:

i) përshkrimi i proceseve kryesore, teknologjia, kapaciteti, lëndët e para, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;

ii) program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;

iii) aktivitete të tjera që mund të kërkojnë si pasojë e projektit (p.sh. rrugë të reja, sigurimi i ujit të pijshëm etj.).

b) Vendndodhjen e projektit:

i) planimetria me kufijtë e projektit;

ii) harta dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;

iii) planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.

c) Ndikimet e mundshme në shëndet dhe mjedis:

i) ndikimet në shëndetin e njerëzve, në florë dhe faunë, në tokë, ujë dhe ajër, në klimë dhe peizazh, në trashëgiminë kulturore dhe historike;

ii) natyra e ndikimeve (direkte, indirekte, të përhershme, të përkohshme, pozitive, negative);

iii) masat për zbutjen e ndikimeve në mjedis;

iv) ndikimet me natyrë ndërkuftare.

2.6.3 Ekstrakt i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për veprimtarinë për të cilën kërkohet leja e mjedisit.



2.6.4 Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i hartuar nga persona fizikë e juridikë të certifikuar e të zgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore.”.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit në MMPAU dhe agjencitë rajonale të mjedisit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

UDHËZIM
Nr.6, datë 28.2.2012

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Pas pikës 2.4 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

2.4.1 Për mineralin apo nënproduktin e eksportuar, eksportuesi paguan taksën e rentës minerare në çastin e bërjes së deklaratës doganore. Paga mbi të dhënat e deklaratës së eksportit bëhet pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e eksportimit nga subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit, kur ky i fundit eksporton vetë mineralin apo nënproduktin e prodhuar prej tij. Nëse subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin e nxjerrë nga miniera apo nënproduktin e prodhuar prej tij nëpërmjet një subjekti tjetër të vetëm eksportues, pagesa e rentës bëhet si nga zotëruesi i lejes, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku ai është regjistruar, ashtu dhe nga subjekti eksportues, pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e eksportimit. Subjekti eksportues në këtë rast rimburohet në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2.4.2 Kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit shet për konsum final brenda vendit mineralin apo nënproduktin e prodhuar prej tij, ai paguan taksën e rentës minerare në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar për të gjithë sasinë e shitur brenda datës 15 të muajt pasardhës dhe brenda datës 20 rakordon me drejtorinë rajonale tatimore përkatëse për taksën e rentës minerare të paguar. Modeli i aktit të rakordimit dhe përmbajtja e tij do të jetë sipas formularit nr. 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij. Akti i rakordimit do të jetë i firmosur nga inspektori i taksave i drejtorisë rajonale tatimore dhe administratori i subjektit të licencuar, zotërues i lejes së shfrytëzimit. Aktit të rakordimit i bashkëlidhen të gjitha faturat e shitjes, si dhe mandatpagesat e taksës së rentës minerare për mineralin apo nënproduktin e shitur për konsum final brenda vendit apo për eksport. Dokumentacioni i mësipërm depozitohet me protokoll pranë drejtorisë rajonale tatimore përkatëse nga subjekti tatimpagues, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit.

2.4.3 Njësitë e qeverisjes vendore ku subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit zhvillon aktivitetin minerar, brenda datës 30 të çdo muaji, sipas formularit nr. 8 bashkëlidhur si pjesë

përbërëse e këtij udhëzimi, bëjnë rakordimin me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave për rentën minerare të mbledhur prej tyre. Një kopje të rakordimit, njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 5 të muajit pasardhës, e dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

2.4.4 Drejtoritë rajonale tatimore dhe degët doganore të cilat janë agjentë tatimorë, brenda datës 30 të çdo muaji dërgojnë informacion analitik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, për vlerën e rentës minerare të mbledhur, subjektin tatimor dhe njësitë e qeverisjes vendore ku kryhet aktiviteti, sipas formularit nr.9 bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.

2.4.5 Shpërndarja e të ardhurave të rentës minerare për komunat dhe bashkitë të cilat përfshihen në territorin e shoqërive (subjekteve), që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit të naftës dhe që paguajnë rentën minerare, bëhet bazuar në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.

2.4.6 Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, që u takon njësitë të qeverisjes vendore (përfshirë edhe ato të naftës sipas pikës 2.4.5), shpërndahet nga strukturat përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave, sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në aneksin nr.1 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”. Sipas këtij aneksi, njësitë e qeverisjes vendore përfitojnë +20 për qind rentë minerare mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi transfertat dhe renta të jenë barazuar.

2.4.7 Ministria e Financave njofton zyrtarisht drejtorinë rajonale të tatimeve, degën doganore respektive dhe njësinë e qeverisjes vendore, për masën e llogaritur të shpërndarjes së të ardhurave nga renta sipas pikës 2.4.6 të këtij udhëzimi. Drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave paraqesin kërkesën për transferimin e fondit në degën përkatëse të thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet drejtoria rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon duke përdorur metodën e transferimeve të brendshme në sistemin e informatizuar financiar të qeverisë.

Për shembull: Njësia vendore “X” sipas tabelës 3 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, përfiton 10 000 mijë lekë transfertë të pakushtëzuar për vitin 2012. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave për disbursimin e rentës për njësitë vendore, kryen përllogaritjet e mëposhtme:

a) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave, rezulton që njësia “X” përfiton 9 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë meqenëse renta minerare është më e vogël sesa transfertat e pakushtëzuar ($9\ 000 < 10\ 000$), kjo njësi nuk përfiton pjesë nga renta minerare.

b) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave rezulton se njësia “X” përfiton 10 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë meqenëse renta minerare është e barabartë me transfertën e pakushtëzuar ($10\ 000 = 10\ 000$), kjo njësi nuk përfiton pjesë nga renta minerare.

c) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave, rezulton që njësia “X” përfiton 12 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë sipas aneksit nr. 1 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e viti 2012”, njësisë “X” i takon t’i disbursohen deri në +20 për qind rentë minerare mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi transfertat dhe renta janë barazuar. Pra, $0.2 \times 10\ 000$ mijë lekë = 2 000 mijë lekë sipas kushtit që renta është 12 000 mijë lekë ($12\ 000 - 10\ 000 = 2\ 000 = +20$ për qind).

Në këtë rast, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave njofton drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave dhe njëkohësisht njësinë vendore “X” për masën e shpërndarjes së rentës minerare për shumën 2 000 mijë lekë në favor të kësaj njësie.

ç) Në rast se njësia vendore “X” sipas informacioneve të drejtorive rajonale të tatimeve dhe doganave, përfiton 11 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë asaj (njësisë “X”) i transferohen 1 000



mijë lekë (meqenëse kushti është deri në +20 për qind mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi renta dhe transfertat të jenë barazuar).

Në këtë rast, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave njofton drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave dhe njëkohësisht njësinë vendore "X" për masën e shpërndarjes së rentës minerare për shumën 1 000 mijë lekë në favor të kësaj njësie.

d) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave rezulton që njësia "X" përfiton 15 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë kësaj njësie duhet t'i transferohen vetëm 2 000 mijë lekë, sepse kjo përfiton +20 për qind mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi kjo të jetë barazuar me rentën. Shuma 15 000 mijë lekë plotëson kushtin e parë që është mbi nivelin e transfertës për 5 000 lekë dhe së dyti transferohen vetëm + 20 për qind mbi transfertën, që në rastin tonë është 2 000 mijë lekë.

Në këtë rast, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave njofton drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave, dhe njëkohësisht njësinë vendore "X" për masën e shpërndarjes së rentës minerare për shumën 2 000 mijë lekë në favor të kësaj njësie.

2.4.8 Procedurat për përdorimin e fondit të çelur sipas pikës 2.4.7 janë të njëjta me ato të përcaktuara në udhëzimin nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

SHTOJCA NR.1

SHPËRNDARJA E RENTËS MINERARE ME PUSHTETIN VENDOR PËR PRODUKTET E NAFTËS DHE GAZIT

Administrata qendrore tatimore dhe administrata doganore, për rentën minerare të paguar nga subjektet e mëposhtme, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e hidrokarbureve, nga totali i rentës së paguar, 25% e të ardhurave mujore nga kjo rentë, ndahet në % sipas komunave dhe bashkive të specifikuar si më poshtë.

1. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Bankers Petroleum Albania Ltd." për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Patos, Marinëz, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 16.7.2004:

- Bashkia Patos	20%;
- Bashkia Roskovec	4%;
- Komuna Mbrostar	13%;
- Komuna Zharrëz	20%;
- Komuna Kuman	30%;
- Komuna Portëz	7%;
- Komuna Ruzhdie	1%;
- Komuna Bubullimë	5%.

2. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Stream Oil&Gas", për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Ballsh, Hekal, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- Komuna Hekal	20%;
- Komuna Qendër Mallakastër	80%.

3. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë “Stream Oil&Gas”, për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Cakran-Mollaj, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- Komuna Hekal 80%;
- Komuna Qendër Mallakastër 20%.

4. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë “Stream Oil&Gas”, për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Gorisht-Kocul, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- Komuna Vllahinë, Vlorë 100%.

5. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë “Stream Oil&Gas”, për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit Delvinë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- Bashkia Delvinë 100%.

6. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë “Sharewood International Petroleum Ltd.” për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve për vendburimin e naftës Kuçovë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 19.10.2007:

- Komuna Kozarë 45%;
- Komuna Perondi 34%;
- Bashkia Kuçovë 5%;
- Komuna Poshnjë 13%;
- Bashkia Ura Vajgurore 3%.

7. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë “IEC Visoka Inc.” për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Visokë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 27.1.2009:

- Komuna Qendër Mallakastër 45%;
- Komuna Rrushdie 30%;
- Bashkia Patos 25%.

8. Për shpërndarjen e 25% të rentës minerare për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese që administrohen nga “Albpetrol” sh.a., në mbështetje të Marrëveshjes “Albpetrol”, të miratuar me ligjin nr. 7853, datë 29.7.1994 “Për disa shtesa në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)":

A. Vendburimet e gazit:

1. Divjakë-Ballaj

- Bashkia Divjakë 50%;
- Komuna Gosë 50%.

2. Frakull

- Komuna Frakull 60%;
- Komuna Levan 40%.

3. Povelçe

- Komuna Dermenas 100% (Ky vendburim nuk jep prodhim);

4. Panaja

- Komuna Qendër (Vlorë) 100% (Ky vendburim nuk jep prodhim).



B. Vendburimet e naftës:

1. Amonice

- Komuna Sevaster 60%;
- Komuna Vllahinë 40%.

2. Drashovicë

- Komuna Vllahinë 100% (Ky vendburim nuk jep prodhim);

3. Rasë-Pekisht-Murriz

- Komuna Rasë 30%;
- Komuna Shezë 40%;
- Komuna ... (Murrizi) 30%.

4. Finiq-Kranë (i abandonuar)

- Komuna Finiq
- Komuna Mesopotam

5. Rerat Bituminoze Kasnice

- Komuna Ruzhdie 100%.

Formular nr. 7

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE/DEGA DOGANORE

AKTRAKORDIMI ME SUBJEKTIN E LICENCUAR TË TAKSËS SË RENTËS MINERARE

PERIUDHA TATIMORE.....

EMRI I SUBJEKTIT (ZOTËRUES I LEJES)

NIPT:

ADRESA:

Nr.	Emërtimi i mineralit/nënproduktit	Prodhimi në vlerë 000/L	Njësia respektive vendore	Mineral, nënprodukt i shitur		Destinacioni i shitjeve Vend ose eksport	Fatura e shitjes - datë-	Minerali i përdorur për nënproduktin		Taksa e paguar në 000/L		Dokumenti i pagesës nr. datë
				Ton	Vlerë (000/L)			Ton	Vlerë (000/L)	Në tatime	Në doganë	
1	2	3	8	4	5	6	7	9	10	11	12	13

Inspektori
(Emër, mbiemër)

Administratori
(Emër, mbiemër)

Drejtori i Drejtorisë Rajonale
(Emër, mbiemër)

Datë _____

Shënim. Ky aktrakordim përpilohet brenda datës 20 të muajit pasardhës.

**DREJTORIA RAJONALE TATIMORE/DEGA DOGANORE
AKTRAKORDIMI ME NJËSITË VENDORE I PAGESËS SË TAKSËS SË RENTËS MINERARE
PERIUDHA TATIMORE.....**

EMRI I SUBJEKTIT (ZOTËRUES I LEJES)

NIPT:

ADRESA:

Nr.	Emërtimi i mineralit/nënproduktit	Prodhimi në vlerë	Njësia respektive vendore	Mineral, nënprodukt i shitur (000 lekë)		Mineral i përdorur për nënproduktin (në 000 lekë)		Taksa e paguar 000/L	Dokumenti i pagesës nr. datë	Renta e llogaritur e njësisë vendore
				Konsum final	Eksport	Konsum final	Eksport			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

Inspektori tatimor
(Emër, mbiemër)

Inspektori i taksave vendore
(Emër, mbiemër)

Drejtori i Drejtorisë Rajonale
(Emër, mbiemër)

Datë _____

Shënim. Ky aktrakordim përpilohet brenda datës 30 të çdo muaji.

DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE/DOGANAVE _____
Muaji _____ Viti _____

TABELA PËRMBLEDHËSE E RENTËS MINERARE TË ARKËTUAR

Nr.	Emërtimi i subjektit	Njësia/të ku zhvillon aktivitetin	Vlera e rentës minerare të derdhur gjatë muajit (lekë)

Drejtori i Drejtorisë Rajonale
(Firma, vula)

Shënim. Formulari nr. 9 plotësohet nga drejtoritë rajonale tatimore dhe të doganave, dhe dërgohet në Ministrinë e Financave brenda datës 30 të muajit pasardhës, si përmbledhëse e formularëve 7 të dorëzuar nga tatimpaguesit.



KËRKESË
Nr. 692/1, datë 22.2.2012
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor (Milot-Lezhë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, vlerësuar në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Konfirmuar”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale këtij shpronësimi është 433 131 (katërqind e tridhjetë e tri mijë e njëqind e tridhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT MILOT-LEZHË

Nr.	Pronari Emri, atësia, mbiemri	Nr. i pas.	Z.K.	Arë			Shënime
				Sip. (lekë/m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	
1	Minire Xhemal Litja	331/6	1986	608	409	248672	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Lumnije Brahim Dauti	331/23	1986	451	409	184459	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI			1059		433131	

KËRKESË

Shtetasi Arlind Tosku, lindur dhe banues në Baz të rrethit të Matit, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Mirash Ndrec Tosku, lindur më 24.6.1969.

KËRKUES
Arlind Tosku

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 19.3.2012
Doli nga shtypi më 20.3.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë